



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Sarandë

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“Auditim Financiar”

BASHKIA SARANDË

Tiranë, mars 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-7
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Sarandë	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	5-6
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	6-7
II	HYRJA	7-11
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	7
2	Identifikimi i çështjes	7-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e vlerësimit	9
6	Standardet e auditimit	10
7	Metoda e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-39
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Sarandë	11-12
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-39
2.1	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	12-39
IV	REKOMANDIME	39-43

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1099/1 prot., datë 19.11.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Bashkinë Sarandë, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën **982,085** mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën **551,752** mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi. Ky auditim synon të rrisë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve. Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Sarandë për periudhën e aktivitetit të kryer gjatë vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që lidhet me kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, qëndron në rritjen e transparencës së veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe të raportimit financiar.

c. Qëllimi i auditimit, ku përcaktohet edhe periudha nën auditim, konsiston në paraqitjen e objektivave, të cilat përputhen me drejtimit e auditimit:

Për auditimin financiar, qëllimi është vlerësimi nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve, janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është informimi i nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*

d. Metodologjia e përdorur, si dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së bazohet në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet dhe shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe ato që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në bazë të gjykimit profesional të audituesve të pavarur është kryer përzgjedhja e kampioneve për testim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimet në pasqyrat financiare, bazuar në riskun dhe materialitetin.

Nisur nga gjykimi profesional dhe ndjeshmëria e zonave të llogarive, duke pasur parasysh se materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesit vlerësojnë si të mundshëm për të

ndikuar tek përdoruesit e informacionit financiar, është përcaktuar materialiteti në masën 2% për të gjitha zonat e llogarive të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit është marrë në konsideratë niveli i materialitetit prej 19,642 mijë lekë, i llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues janë përdorur teknika auditimi si: kontrolli aritmetik; kontrolli mbi bazën e dokumentacionit justifikues; inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; kontrolli i vlerësimit; konfirmimi nga të tretët; kontrolli sipas treguesve; verifikimi i transaksioneve; intervistimi; analiza e raporteve dhe informacioneve; si dhe përdorimi i pyetësorëve për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave rezulton se institucioni, për periudhën nën auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 5 gjetje dhe ka dhënë 5 rekomandime, të cilat i përkasin kategorisë “*Masa organizative*”.

2. Përshkrimi i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme paraqiten shkurtimisht sipas drejtimeve të mëposhtme:

-Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”, në datën 01.01.2024 paraqitet në vlerën 947,377,449 lekë. Gjatë vitit 2024, për këtë llogari janë evidentuar shtesa në vlerën 41,761,849 lekë, si dhe amortizim i akumuluar në vlerën 326,101,933 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e llogarisë paraqitet në vlerën 928,402,185 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie, u konstatua se vlera 1,761,146 lekë është emërtuar “*Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)*”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare.

- Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në datën 01.01.2024 paraqitet në vlerën 3,075,565,133 lekë. Gjatë vitit 2024, për këtë llogari janë evidentuar shtesa në vlerën 163,420,517 lekë, si dhe amortizim i akumuluar në vlerën 952,643,451 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e llogarisë paraqitet në vlerën 3,047,166,194 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie, u konstatua se vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “*Rikonstruksion*”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare.

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*” u konstatua se, për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*”, është përlllogaritur amortizimi i akumuluar deri në datën 31.12.2024 në vlerën 25,787,766 lekë, mbi koston historike, duke aplikuar normën e amortizimit në masën 20%. Ndërkohë, nuk është kryer ndarja e llogarisë 218/6 “*Pajisje kompjuterike*” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “*Inventar ekonomik*”, për të cilat norma e amortizimit e aplikueshme është në masën 25%.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e veta*” u konstatua se kjo llogari paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 3,462,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqëria Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Sarandë është 584,304,000 lekë, e cila është bërë pjesë e Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë. Pjesëmarrja e Bashkisë Sarandë në kapitalin e kësaj shoqërie është në vlerën

3,462,000 lekë, ose 4.57%. Ndërkohë, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë.

- Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune” u konstatua se nuk ekziston një regjistër kontabël analitik për këto aktive.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara në gjetje, janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Drejtoria Ekonomike në Bashkia Sarandë të marrë masa për analizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” për vlerën 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të marrë masat për analizimin e vlerës 29,568,137 lekë, e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

- Drejtoria Ekonomike të marrë masat për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 “Pajisjet kompjuterike” brenda llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në regjistrin e aseteve të njërive dhe në pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

- Nga Drejtoria Ekonomike të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Ekspertë vlerësues të licencuar të aseteve, të bëhet vlerësimi i pronave të regjistruara por pa vlerë, si dhe të vijohet me regjistrimin në kontabilitet.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Sarandë, KLSH ka dhënë “**Opinioni të Kualifikuar me rezervë**” për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

a. Opinioni i kualifikuar me rezervë¹:

Grupi i auditimit të KLSH-së ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Sarandë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në aktive, pasqyrën e

¹Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së miratuar me Vendimin nr. 246, datë 19.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli VII, pika 4.2, (fq 54, 60-61): “Opinioni i Kualifikuar me Rezervë” do të jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

fluksit të mjeteve monetare, si dhe shënimet shpjeguese përkatëse. Auditimi ka përfshirë shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të dokumentacionit që mbështet shumat dhe regjistrimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi, nga auditimi i pasqyrave financiare të subjektit Bashkia Sarandë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat, sipas gjykimit profesional të audituesit të pavarur, janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, me rezervë.

Bazat për opinionin e kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona në lidhje me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar, në përputhje me ISSAI 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t” dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, si dhe me çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 19,642 mijë lekë, të llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është kontabilizuar vlera 1,761,146 lekë, e emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, si dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është kontabilizuar vlera 29,568,137 lekë, e emërtuar “Rikonstrukion”, të cilat nuk janë të analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqësojnë, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare.

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” konstatohet se, për llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, është përlllogaritur amortizimi i akumuluar në vlerën 25,787,766 lekë (mbi koston historike), duke aplikuar normën e amortizimit në masën 20%. Ndërkohë, nuk është bërë ndarja e llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik”, për të cilat norma e amortizimit e aplikueshme është në masën 25%.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet e nënvlerësuar për vlerën 3,462,000 lekë.

-Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstrukione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune” u konstatua se nuk ekziston një regjistër kontabël analitik për këto aktive.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1099/1 prot., datë 19.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në periudhën nga data 19.11.2025 deri më 12.12.2025, në institucionin Bashkia Sarandë u krye auditimi *Financiar* për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J G (*Përgjegjës grupi*)
2. A D, *anëtar*
3. R F, *anëtar*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme nëse, për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Auditimi financiar synon të vlerësojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit, si dhe përdorimi i burimeve, janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është informimi i nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike, me përzgjedhje kampionesh dhe mbi bazë risku, si dhe duke vlerësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative, me qëllim që auditimi t’i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve. Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të vlerësojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Sarandë dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të tyre.

Gjithashtu, është vlerësuar saktësia, rregullshmëria dhe ndodhja e transaksioneve kontabël, si dhe regjistrimi i tyre në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe gjykimit profesional, audituesit kanë analizuar rezultatet e testeve të kontrollit, klasifikuar gabimet e konstatuara dhe vlerësuar evidencat e grumbulluara për mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre për qëllimet e auditimit.

Procedurat e kryera varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut material si pasojë e mashtrimit apo gabimit, për të përcaktuar procedurat e auditimit më të përshtatshme për rrethanat. Bazuar në procedurat e ndjekura, vlerësojmë se evidencat e mbledhura

janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Sarandë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik, si dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Sarandë, në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë e të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, bazuar në evidencat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion të auditimit. Gjatë auditimit janë zbatuar parimet e auditimit financiar, si: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë, menaxhimi i grupit të auditimit dhe i aftësive të tij, si dhe parimet që lidhen me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet lidhur me klasat e transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si: përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullësia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, si dhe vlerësimi dhe alokimi i tyre. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për sigurimin e një niveli të arsyeshëm sigurie nëse veprimtaria e Bashkisë Sarandë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për hartimin e një raporti auditimi që përfaqëson opinionin përkatës. Siguria e arsyeshme përfaqëson një nivel të lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi, i kryer në përputhje me standardet, do të identifikojë çdo gabim apo anomali që mund të ekzistojë.

Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi për identifikimin e çështjeve më të rëndësishme që lidhen me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative mbi të cilat mbështetet veprimtaria e subjektit të audituar, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon publikimin e tyre ose kur, në raste të veçanta, vlerësohet se publikimi i tyre mund të sjellë pasoja negative për interesin publik. Audituesit kanë gjithashtu përgjegjësinë të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafët 44–51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore, si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;

- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së bazohet në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet dhe shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe në ato që vlerësohen me nivel të lartë risku. Bazuar në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, kryhet përzgjedhja e kampioneve për verifikim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin²: Nisur nga gjykimi profesional dhe ndjeshmëria e zonave të llogarive, duke pasur parasysh se materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të ndikuar tek përdoruesit e informacionit financiar, është përcaktuar niveli i materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarive të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik: Duke marrë në konsideratë se kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve ekonomike në formë numerike dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërmjet regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre sintetike kryhen një sërë veprimesh që lidhen me evidentimin në llogari, mbartjen, klasifikimin dhe rigrupimin e të dhënave. Kontrolli aritmetik është kryer me qëllim verifikimin e saktësisë së veprimeve llogaritëse dhe të regjistrimeve në llogaritë përkatëse, të cilat përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike (*Ditari i kontabilizimit të urdhër-shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese: Edhe pse kontabilizimet mund të mos përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të rezultojnë të pasakta nëse regjistrimet e kryera nuk përputhen me realitetin ekonomik. Kontrolli me zgjedhje i dokumentacionit justifikues (*urdhër-shpenzimeve*) është kryer për të verifikuar nëse shifrat e regjistruara mbështeten në dokumentacion të mjaftueshëm dhe të rregullt. Ky verifikim është kryer në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese: Kontrolli konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive dhe librave kontabël. Kontrolli kontabël i ushtruar verifikoi përputhjen

² ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

ndërmjet regjistrimeve kontabël dhe dokumentacionit justifikues përkatës, duke u siguruar gjithashtu për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit: Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat e atribuuara gjendjeve ekzistuese janë të sakta dhe nëse pasuritë duhet të paraqiten në bilanc me vlerat e caktuara për to.

5. Konfirmim nga të tretët: Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

6. Kontrolli sipas një treguesi: Është përdorur analiza e treguesve statistikorë me qëllim identifikimin e fakteve ose të dhënave “*jashtë normales*”, të cilat mund të përbëjnë tregues të parregullsisive kontabël, si: mungesa e dokumentacionit justifikues, gabime të shpeshta në data, numra, referenca të brendshme apo emra, regjistrime pak të lexueshme, renditje e pasaktë e shifrave, si dhe korrigjime të shumta të tyre.

- *Verifikimi i transaksioneve:* Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke i krahasuar midis tyre.

- *Intervistimi:* Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raporti i Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresën nr. 1099/2 prot., datë 13.01.2026. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Sarandë”:

Bashkia e Sarandë kufizohet në veri me Bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me Bashkinë Finiq dhe në perëndim me Detin Jon. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia Sarandë është njësi vendore e pavarur dhe, pas ndarjes së re territoriale, përbëhet nga ish-Bashkia Sarandë dhe ish-Komuna Ksamil, e cila aktualisht funksionon si Njësi Administrative.

Bashkia e re Sarandë shtrihet përgjatë vijës bregdetare, nga Koka e Qefalit në veri deri te Kanali i Vivari në jug, ku shërbimet e turizmit detar dhe kulturor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave.

Fshati i Çukë, i cili u shkëput nga Saranda në vitin 1996 për të kaluar në varësi të ish-Komunës Aliko, u rikthye me reformën aktuale territoriale në varësi të Sarandës.

Asetet kryesore ekonomike të territorit janë deti, peshkimi, liqeni i Butrint dhe pasuritë e shumta arkeologjike, përfshirë Parku Arkeologjik i Butrintit, si dhe objekte të tjera me rëndësi historike e kulturore, si Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Lëkurësit, Manastiri i Shën Gjergjit dhe rrënojat e kalasë së qytetit. Në territorin e kësaj bashkie ndodhen 118 objekte të regjistruara si monumente kulture të kategorisë së parë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

2.1.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;

2.1.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës;

Për auditimin mbi vlerësimin e raportimit financiar, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 1, datë 12.12.2025, i cili synon arritjen në opinionin nëse pasqyrat financiare të Bashkisë Sarandë për vitin 2024 japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, grupi i auditimit është mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si më poshtë:

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Në vijim, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës, pyetësorët e adresuar pranë institucionit si dhe informacionin e grumbulluar nga intervistat zhvilluar me stafin e ngarkuar për procesin e përgatitjes, verifikimit, miratimit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare.

Me qëllim verifikimin e ekzistencës dhe funksionimit të masave të brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit, forcimin e integritetit dhe sigurimin e paanshmërisë në procesin e raportimit financiar, grupi i auditimit kërkoi dhe shqyrtoi dokumentacion lidhur me pavarësinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, ndarjen e funksioneve, vlerësimin etik të personelit financiar dhe transparencën e procesit të raportimit financiar për vitin 2024.

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion u konstatua se në Bashkinë Sarandë mungojnë mekanizma të dokumentuar për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, nuk është formalizuar proces vlerësimi etik apo kontroll i brendshëm mbi personelin financiar dhe nuk administrohen deklarata të konfliktit të interesit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9367/2005 dhe ligjit nr. 10296/2010, “*Për menaxhimin*

financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;. Këto mangësi rrisin riskun që raportimi financiar të ndikohet nga interesa personale dhe të çënohet integriteti, paanshmëria dhe besueshmëria e informacionit financiar. Ndërkohë, nga auditimi u konstatua se ndarja e funksioneve në procesin e raportimit financiar është e dokumentuar dhe, përveç rasteve të arkave në njësitë administrative, nuk janë evidentuar ushtrime funksionesh të dyfishta nga i njëjti individ.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin **2024** në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (*Klasifikimi sipas natyrës ekonomike*).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (*Cash Flow*).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (*kosto historike*).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (*vlera neto*).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Në lidhje me këto formate u konstatua se:

Formatet financiare dhe statistike të sipërcituara janë përgatitur në përputhje me kërkesat formale të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, por cilësia dhe plotësia e të dhënave të pasqyruara në to varet nga proceset paraprake të regjistrimit, verifikimit dhe miratimit të informacionit financiar.

Në formatet e përgatitura, të cilat përmbledhin në mënyrë shumatore të dhënat e raportuara nga njësitë vartëse, mungojnë shënimet shpjeguese dhe dokumentacionet mbështetëse mbi proceset e kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit që ka shërbyer si bazë për regjistrimin e të dhënave në pasqyrat financiare (*të konsoliduara*), si dhe nuk dokumentohen arsyet e lëvizjeve ndërvite të zërave buxhetorë, siç kërkohet nga struktura raportuese, Gjithashtu nuk evidentohet dokumentacion mbështetës në dosjen e raportimit financiar, çka kufizon gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e saktësisë së të dhënave të pasqyruara, konkretisht:

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes vendore subjekt në auditim rezulton se në raportimin financiar për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2024 struktura standarte e formularëve “*Formati nr.1*” deri te “*Formati 8*” janë hartuar duke respektuar ndarjen funksionale si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar: Struktura standarte e formularit “*Formati nr.1*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në Aktive, Pasive dhe Aktive Neto/Fonde, me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyra e performancës financiare; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.2*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: **A.Të Ardhurat**, sipas nënkategorive, konkretisht: *Të ardhurat nga Taksat dhe Tatimet; Kontribute Sigurime Shoqërore e Shëndetësore; Të Ardhura Jo Tatimore; Të Ardhura Financiare, Grante Korente; Të Ardhura të tjera; Ndryshimi i gjendjes së inventarit ekonomik.* **B. Shpenzimet** sipas nënkategorive, konkretisht: *Pagat dhe Perfitimet e Punonjësve; Kontribute të Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore; Blerje Mallra e Shërbime; Subveçione, Transferime Korente; Shpenzime Financiare; Kuota Amortizimi dhe Shuma të Parashikuara; Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit; Shpenzime të tjera; Teprica ose Defiçiti i Periudhës (Rezultati i Veprimtarisë së Vitit Ushtrimor).*

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive kontabël me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyra e flukseve monetare; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.3*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: Veprimtaritë e Shfrytëzimit; Veprimtaritë e Investimeve; Transferta e të tjera; Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare; Teprica në fillim të vitit ushtrimor; Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive kontabël me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.4*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: Aktivet Neto/Fondet Neto; Ndryshimet në Aktivet/ Fondet Neto; Totali i Fondeve të veta.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive kontabël si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pyetësori me shënimet shpjeguese; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.5*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale dhe është pjesë integrale e pasqyrave për vitin ushtrimor.

Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.6*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: Shpenzimet për investime; Burimet për investime.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive kontabël si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b); Struktura standarte e formularit “*Formati nr.7 (a) dhe (b)*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale dhe është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive kontabël si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave; Struktura standarte e formularit “*Formati nr.8*” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: Personel drejtues; Specialist me arsim të lartë; Teknik; Nëpunës të thjeshtë; Punëtorë dhe punonjës të përkohshëm.

Struktura është plotësuar me informacion të qartë mbi ndryshimet gjatë vitit (punonjës të rinj, të larguar si dhe fondin respektiv për paga dhe kontribute mbi sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore) në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Sarandë për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. O. Ç. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. T. S. Drejtor Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Sarandë me shkresën nr. 2040 prot., datë 27.03.2025, dhe konfirmuar nga DTH Sarandë me shkresën nr. 161 prot., datë 27.03.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (*dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se *nuk ka diferencë*. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (*çeljet*) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (*vlerësimi kontabël*);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- a). Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- b). Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- c). Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (*barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive*) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se

- Kontabiliteti përgjithësisht është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Përgjithësisht janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Në përgjithësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues përgjithësisht është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si *urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat*, janë të hartuara përgjithësisht me elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si *kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj..* Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si *faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj..*

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë në përgjithësi informacion mbi elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Sarandë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024**. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria ekonomike janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Në dhënien e opinionit është marrë në konsideratë niveli i materialitetit prej 19,642 mijë lekë, i llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues janë përdorur teknika auditimi si: kontrolli aritmetik; kontrolli mbi bazën e dokumentacionit justifikues; inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; kontrolli i vlerësimit; konfirmimi nga të tretët; kontrolli sipas treguesve; verifikimi i transaksioneve; intervistimi; analiza e raporteve dhe informacioneve; si dhe përdorimi i pyetësorëve për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Mbi vlerësimin e riskut:

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm: Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Sarandë nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar drejtuesit se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët: Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (*rakorduara*) me të tretët (*me degën e thesarit*) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet: Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përlogaritur **15,564 mijë lekë** për të ardhurat **19,642 mijë lekë** për shpenzimet u evidentuan të gjitha kontabilizimet sipas llogarive që ishin materiale në vlerë për të ardhurat dhe Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës që ishin materiale në vlerë për muajin dhjetor 2024. Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si: *Dokumentet autorizues; Dokumentet vërtetues; Dokumentet e kontabilitetit*, etj.

Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik: Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese: Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se përgjithësisht shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese: Konsistoi në ekzaminimin e: *Aktiveve; Llogarive; Librave Kontabël* etj. Kontrolli kontabël i ushtruar testoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit: Kontrolli i vlerësimeve përcakttoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët: Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (*rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi: Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka *mungesa të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme*, etj.

2.3.1 Auditimi mbi Plotësinë dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Procesi i inventarizimit: Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në: Gjendjen e Aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”: Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”; kartelat sipas personave të cilën kanë Aktive në përdorim; Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit; Relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit; Procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit; Fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese u konstatua se:

Në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2024 për Bashkinë Sarandë.

Nga Kryetari i Bashkisë për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2024 kanë dalë urdhrat nr. 252, datë 05.12.2024, “Për krijimin e komisioneve të inventarizimit të aktiveve afatgjata të Bashkisë Sarandë” dhe nr. 251, datë 05.12.2025, “Për inventarizimin e materialeve të magazinës”. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit janë mbajtur procesverbalet përkatëse nga secili komisioni si dhe është hartuar edhe relacioni shpjegues.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit u konstatua se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të Aktiveve të Qëndrueshme të Patrupëzuara e të Trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive kontabël për Bashkinë Sarandë . Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit e materialeve brenda muajit dhjetor 2024.

Nga shqyrtimi i bartësve të informacionit kontabël (*mandate arkëtimi, mandate pagese, fletë-hyrje, fletë-dalje, ditarë, kartela artikujsh, libër i magazinës, ditar i shpenzimeve, ditar banke, libër i llogarive, pasqyrat financiare etj.*) rezultoi se ngjarjet përgjithësisht janë pasqyruar në pasqyrat financiare por si pasojë e vloumeve dhe mungësës së sistemeve elektronike financiare (*programe elektronike*) ky institucion nuk ka mbajtur të plotë ciklin e regjistrimeve kontabël dhe të magazinës. Në ditarin e magazinës, regjistrimet për hyrjet nuk përmbajnë të dhëna të detajuara mbi produktet/artikujt e blera (*emërtim, sasi, vlerë, subjekt, datë, origjinë*), por vetëm datën dhe emrin e furnitorit, gjithashtu pjesë e informacionit të këtij bartësi është edhe veprimi kontabël mbi llogaritë kontabël përkatëse – një praktikë që i përket një faze tjetër të ciklit kontabël. E njëjta mangësi është konstatuar edhe për daljet, ku mungojnë të dhëna mbi produktin/artikullin e dalë, sasinë, kërkesën mbi të cilën është bërë dalja dhe destinacionin përfundimtar të produktit. Pra në të gjitha raste, hyrjet dhe daljet janë regjistruar drejtpërdrejt në ditarin e shpenzimeve, duke kryer njëkohësisht veprim kontabël mbi llogaritë përkatëse – një praktikë që i përket një faze tjetër të ciklit kontabël.

Njësitë vartëse nuk kanë dokumentuar kontrollet periodike të magazinës dhe asnjë rakordim mujor midis kartelave të magazinës dhe regjistrimeve kontabël. Bashkia, nëpërmjet strukturave

përgjegjëse, nuk ka kërkuar raporte krahasuese të shtesave dhe pakësimeve me shpjegime për ndryshimet me vlera të larta.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultojnë procesverbale inventarizimi fizik dhe rakordim me atë kontabël, por në gjithë fazat e ciklit kontabël, (*libër i magazinës, ditar i shpenzimeve, ditar banke, libër i llogarive, pasqyrat financiare etj*) nuk u konstatuan të dhëna apo relacione konkrete të cilat japin informacion mbi shtesën apo pakësimin e artikujve konkrete përveç informacioneve të përmendura më sipër, konkretisht:

- Për hyrjet në magazinë konstatohet vetëm informacion mbi datën, emrin e furnitorit edhe veprimi kontabël mbi llogaritë përkatëse.
- Për daljet nga mangazina konstatohet vetëm informacion mbi datën, emrin e personit që e tërheq edhe veprimi kontabël mbi llogaritë përkatëse.

Duke marrë në konsideratë se për hyrjet në magazinë duhet ndjekur kjo praktikë/procedurë:

1. Plotësimi i fletë-hyrjes mbasi është realizuar blerja dhe mallrat e marrë në dorëzim nga komisioni i shtohen zërave të magazinës. Ky informacion i cili përmban të dhënat identifikuese lidhur me produktin/artikullin e blerë, konkretisht *emërtim, sasi, vlerë, subjekt furnitor, datë, origjinë* është shumë i rëndësishëm **për përcaktimin e inventarit kontabël lidhur me shtesat.**

Të dhënat e domosdoshme për plotësimin të bartësit të informacionit kontabël dhe një ndër formatet e përshtatshme të një ditari magazine për hyrjet paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra me të dhënat e domosdoshme të një ditari magazine;

F.H. NR	DATA	Përshkrimi	ARTIKULLI	NJESIA	SASIA	VLEFTA	TOTALI	ORIGJINA	Te dhena te tjera
1	04.12.2024	Dhurim materiale te ndryshme	BAZAMENT BETONI	cope	100	0	0	Kontratë DHURIMI NR.383 PROT, DT.29/05/2024	
2	04.12.2024	Blerje Sinjalistike	Shtylla Metalike	cope	60	12600	756000	Kontrate Blerje Sinjalistike për hapësirat publike, Nr Prot 234/12, Dt 12.06.2024	
3	10.12.2024	Blerje Sinjalistike	Krahe per koka ndricimi	cope	60	2400	144000	Kontrate Blerje Sinjalistike për hapësirat publike, Nr Prot 234/12, Dt 12.06.2024	
4	16.12.2024	Blerje Materiale Pastrimi	Acid per Pastrim	cope	90	144	12960	Kontrate Blerje Materiale Pastrimi, Nr Prot 382/11, Dt 28.07.2024	
5	17.12.2024	Blerje Materiale Pastrimi	Xhel Dezinfektues	cope	73	240	17520	Kontrate Blerje Materiale Pastrimi, Nr Prot 382/11, Dt 28.07.2024	
6	Anulluar	Blerje Materiale Ndertimi	Cakell per mbushje	m3	130	420	54600	Kontrate Blerje Materiale Ndertimi, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
7	19.12.2024	Blerje Materiale Ndertimi	Beton I gatshem c20/25 me cakell	m3	62	8880	550560	Kontrate Blerje Materiale Ndertimi, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
8	23.12.2024	Blerje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash metalik	cope	60	40800	2448000	Kontrate Blerje Koshash, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
9	23.12.2024	Blerje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash plastik	cope	60	27600	1656000	Kontrate Blerje Koshash, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	

Pasqyra e një ditari magazine të njësisë sipas të dhënave të marra në shqyrtim nga grupi i auditimit është:
Aparati

F.H. NR	DATA	Përshkrimi	DEBI					KREDI			
			312		218			45	K 630	101	45
			3120000	3121100	2187100	2186100	2140290				
			M.Z.te pegj	M.Spec	Te tjera	Kompju	Pj aud-viz				
129	04.12.2024	Subjekti x	xxxxxxx						xxxx	xxx!	-
130	04.12.2024	Subjekti x							xxxx	xxx	-
131	04.12.2024	Subjekti x		xxxxxxx					xxxxxx	xxxx	-
132	10.12.2024	Subjekti x	xxxxx						xxxx	xxxx	-
133	13.12.2024	Subjekti x	xx		1,538,500.00	468,000.00	150,000.00		xxxxx	xxxx	-
134	13.12.2024	Subjekti x			xxxxx				xxxx	xxxx	-

- Për daljet nga mangazina hapat që ndiqen janë:

1. Plotësimi i dokumentacionit mbështetës për tërheqjen, konkretisht:

- a. Kërkesa e plotësuar dhe nënshkruar nga sektori ose drejtorja për tërheqjen e produktit/artikullit sipas nevojës që kanë për produkte/artikuj.
- b. Urdhër veprimi i protokolluar i miratuar nga NZ dhe NA (*ose personi të cilit i delegohet kjo kompetencë*). Ky dokument autorizon personin përgjegjës për magazinën që bazuar në këtë

urdhër veprim të vendosen në dispozicion produktet/mallrat për plotësimin e nevojave të sektorit/drejtorisë që ka paraqitur në kërkesë.

2. Plotësimi i fletë-daljes mbasi është konfirmuar nga mangazinieri plotësimi i dokumentacionit mbështetës për daljen dhe dorëzimi i produktit/artikullit të kërkuar.

Mangazina pas plotësimit të fletë-daljes kryen pakësimin e zërave të mangazinës për produktin/artikullin e përshkruar në fletë-dalje.

3. Pjesë e dokumentacionit të mangazinës bëhet edhe një kopje e proces-verbalit të marrjes në dorëzim ose dokumentacioni i cili vërteton destinacionin final ku ka shkuar produkti/artikulli.

Ky informacion i cili përmban të dhënat identifikuese lidhur me produktin/artikullin e dalë nga mangazina për plotësimin e nevojave të njësisë, konkretisht emërtim, sasi, vlerë, destinacionin, datë, është shumë i rëndësishëm **për përcaktimin e inventarit kontabël lidhur me pakësimet.**

Të dhënat e domosdoshme dhe një ndër formatet e përshtatshme të një ditari magazine për hyrjet paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra me të dhënat e domosdoshme të një ditari magazine;

Ditari i daljeve të mangazinës													
Kërkesa nr. prot	Urdhër veprimi nr. prot	Datë	F.D. NR	DATA	Përshkrimi	ARTIKULLI	NJESIA	SASIA	VLEFETA	TOTALI	Destinacioni	Proces verbal i dorezimi nr.	Datë
1	1	09.06.2024	1	04.12.2024	Dalje materiale te ndryshme	BAZAMENT BETONI	cope	0	0	0	xxxx	1	xxxx
2	2	09.06.2024	2	04.12.2024	Dalje materiale Sinjalistike	Shtylla Metalike	cope	0	12600	0	xxxx	2	
3	3	09.06.2024	3	10.12.2024	Dalje materiale Sinjalistike	Krahe per koka ndricimi	cope	0	2400	0	xxxx	3	
4	4	09.06.2024	4	16.12.2024	Dalje Materiale Pastrimi	Acid per Pastrim	cope	0	144	0	xxxx	4	
5	5	09.06.2024	5	17.12.2024	Dalje Materiale Pastrimi	Xhel Dezinfektues	cope	0	240	0	xxxx	5	
6	6	09.06.2024	6	Anulluar	Dalje Materiale Ndertimi	Cakell per mbushje	m3	0	420	0	xxxx	6	
7	7	09.06.2024	7	19.12.2024	Dalje Materiale Ndertimi	Beton 1 gatshem c20/25 me cakell	m3	0	8880	0	xxxx	7	
8	8	09.06.2024	8	23.12.2024	Dalje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash metalik	cope	0	40800	0	xxxx	8	
9	9	09.06.2024	9	23.12.2024	Dalje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash plastik	cope	0	27600	0	xxxx	9	

Pasqyra e një ditari magazine të njësisë sipas të dhënave të marra në shqyrtim nga grupi i auditimit është:
Aparati;

F.D. NR	DATA	Pershkrimi	D					K			
			630	218	211	etj	45	312	211	218	45
754	04.12.2024	Punonjesi x	8,633.31					8,633.31			
755	04.12.2024	Punonjesi y			3,741,477.60				3,741,477.60		
756	04.12.2024	Punonjesi z	43,200.00					43,200.00			
757	04.12.2024	Punonjesi y		9,600.00						9,600.00	
758	04.12.2024	Punonjesi y	4,320.79					4,320.79			
759	04.12.2024	Punonjesi z		73,200.00						73,200.00	
760	05.12.2024	Punonjesi y	1,800.00					1,800.00			

Konkluzion: Regjistrimi i plotë në ditarin e mangazinës mbi “Hyrjet” (*shtesat e produkteve/artikujve*) dhe “Daljet” (*pakësimet e produkteve/artikujve*) e produkteve/artikujve në mangazinë janë procesi i cili përcakton qarkullimin e inventarëve pra gjendjen e inventarit kontabël të njësisë. Inventari kontabël si pjesë përbërëse procesit të inventarizimit vjetor që kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ka në thelb rakordimin midis inventarizimit fizik dhe kontabël. Nëse informacioni i nevojshëm për përcaktimin e inventarit kontabël ndalon së pasqyruari (*mbartur*) në të dhënat të cilat gjendjen vetëm në fazat fillestare të blerjes (*faturë blerje, marje në dorëzim fletë hyrje dhe fletë dalje*) atëherë të dhënat e paraqitura në procesverbalet e inventarizimit mbi rakordimin kontabël me inventarin fizik paraqesin risk dhe mungesë të gjurmës së auditimit. Sa më sipër e bën të pamundur të përcaktohet me saktësi dhe konform kuadrit regullator sasia kontabël e materialeve në fund të vitit financiar.

Sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, dhe UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë lëvizjet e materialeve, inventarit dhe produkteve në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar, duke siguruar përputhje ndërmjet regjistrimeve kontabël dhe inventarit fizik. Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.

Mosmbajtja e ciklit të plotë të bartësve të informacionit kontabël, mungesa e detajimit të hyrjeve dhe daljeve në regjistrat e magazinës, dhe mospërfshirja e kontrolleve mujore dhe inventarizimit fizik, përbëjnë risk për mosrakordim midis pasqyrave financiare dhe inventarit fizik, mospërputhje ndërmjet vlerës kontabël dhe ekzistencës reale të aseteve, si dhe pamundësi për verifikim të plotësisë dhe saktësisë së transaksioneve.

Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi institucionet duhet të që:

1. Për çdo veprim financiar dhe material të kryejnë monitorimin mbi mbajtjen dhe plotësimin korrekt të gjithë bartësve të informacionit kontabël sipas strukturave të miratuara duke i dhënë rëndësi plotësimi të çdo bartësi me informacionin për të cilin ky bartës është krijuar dhe duke shmangur bashkimin e tyre;
2. Plotësimi i ditarit të magazinës të kryhet vetëm për të dhëna që ndihmojnë funksionimin e njësisë, duke siguruar që çdo hyrje dhe dalje të shoqërohet me të dhëna të detajuara mbi artikullin, sasinë, datën, kërkesën dhe destinacionin;
3. Të kryejnë nëpërmjet strukturave përgjegjëse kontrolle të brendshme periodike për rakordimin mujor të magazinës me librat kontabël;
4. Të kërkojnë raporte krahasuese të shtesave dhe pakësimeve nga çdo njësi vartëse, me analiza shpjeguese për ndryshimet e mëdha;

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Sarandë, “Formati nr. I”, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktiviteti Neto janë të barabarta me Aktivitet - Pasive = Aktiviteti Neto		5,932,096,777
Aktivitet		5,932,096,777
Pasivitet		877,320,693
Aktiviteti Neto		5,054,776,084

		Lekë
Aktiviteti Afatshkurtra më datë 31.12.2024		1,681,610,105
Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”		850,014,962
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		11,235,039
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		820,360,104

A. AKTIVET

I. Aktiviteti Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

					Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	
531	Mjete monetare në arkë	0	0		0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0		0
520	Disponibilitete në thesar	850,014,962	651,705,360		198,309,602
50	Letra me vlerë	0	0		0

532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizijone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		850,014,962	651,705,360	198,309,602

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” më datë 01.01.2024 paraqitet në vlerën 651,705,360 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 850,014,962 lekë, duke rezultuar një ndryshim gjatë vitit ushtrimor në vlerën 198,309,602 lekë.

Në pasqyrat financiare për të njëjtën periudhë, llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 675,776,994 lekë, ndërsa llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në vlerën 56,960,589 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancive kontraktuale të mbajtura në Thesar.

Në analizën e këtyre treguesve është marrë në konsideratë fakti se llogaria 85 përfshin rezultatin kontabël të ushtrimit që rrjedh nga mbyllja e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe elementë të tjerë kontabël që nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht lëvizje monetare, si p.sh. ndryshimet në gjendjen e inventarit.

Për qëllime analize dhe interpretimi të lidhjes ndërmjet treguesve kryesorë të pasqyrave financiare paraqitet krahasimi i mëposhtëm:

Përshkrimi

Ndryshimi i gjendjes së llogarisë 520 gjatë vitit	Vlera (lekë) 198,309,602
Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”	675,776,994
Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	56,960,589
Diferenca e analizuar	117,277,379

Analiza e mësipërme paraqitet në funksion të rakordimit dhe interpretimit të treguesve të pasqyrave financiare, duke marrë në konsideratë lidhjen ndërmjet rezultatit kontabël të ushtrimit dhe gjendjes së mjeteve monetare në Thesar.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	3,848,153	4,022,601	(174,448)
32	Inventar i imët	7,386,886	6,832,486	554,400
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizijone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		11,235,039	10,855,087	379,952

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqiten në vlerën 11,235,039 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 3,848,153 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 7,386,886 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 379,952 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 379,952 lekë, **në përputhje me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1 “Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to”.

- **Llogaria 31 “Materiale”,** ka vlerën 3,848,153 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024		4,022,601
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		174,448
Gjendja në 31.12.2024		3,848,153

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 7,386,886 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024		6,832,486
Shtesa (K)		554,400
Pakësime (D)		0
Gjendja në 31.12.2024		7,386,886

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	Lekë
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë të ndryshëm	794,848,106	672,416,005	122,432,101	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	25,511,998	20,619,817	4,892,181	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	820,360,104	693,035,822	127,324,282	
	Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0	
	Totali	0	0	0	

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 672,416,005 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 794,848,106 lekë me një rritje në vlerën 122,432,101 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		672,416,005
Shtesa (K)		122,387,228
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		794,848,106

Me shkresën nr. 1073 prot., datë 17.02.2025, znj. I. Zh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ka paraqitur pranë Drejtorisë Ekonomike përmbledhësen mbi situatën debitore nga taksat dhe tarifave vendore më datë 31.12.2024, vlerë e cila është e kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Sipas listë analitike përfshihen 3,500 debitorë me vlerë 601,761,925 lekë si dhe një listë tjetër analitike prej 489 subjekte debitorë në vlerën 193,086,181 lekë, **në përputhje me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 20,619,817 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 25,511,998 lekë me një rritje në vlerën 4,892,171 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)		Lekë
Çelje e vitit 2024		20,619,817
Shtesa (K)		10,805,991
Pakësime (D)		5,913,810
Gjendja debitore në 31.12.2024		25,511,998

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 4,682,077 lekë; 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 13,661,605 lekë; 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,554,528 lekë; 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,160,451 lekë; 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 584,817 lekë; 437,438 “Organizma të tjerë shtetërore” në vlerë 80,820 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 787,700 lekë ku totali shkon në vlerën 25,511,998 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 25,511,998 lekë dhe llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit”, në përputhje me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	4,210,036,480	4,259,331,377	(49,294,897)
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	13,853,480	8,106,991	5,746,489
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	13,853,480	8,106,991	5,746,489
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	4,196,183,000	4,251,224,386	(55,041,386)
210	Toka, Troje, Terene	77,350,197	77,350,197	0
211	Pyje, Plantacione	83,323,719	83,323,719	0
212	Ndërtesa e konstruksione	928,402,185	947,377,449	(18,975,264)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	3,047,166,194	3,075,565,133	(28,398,939)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	44,031,406	40,230,912	3,800,494
215	Mjete transporti	15,089,155	21,566,866	(6,477,711)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	820,144	5,810,100	(4,989,956)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	40,450,192	0	40,450,192
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	40,450,192	0	40,450,192

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 8,106,991 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,913,860 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 31,502,854 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,853,480 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.*) në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		Lekë
27,335,4 Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		35,442,474
	2	Amortizim i akumuluar		27,335,483
	3	Gjendja në 01.01.2024		8,106,991
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		9,913,860
	5	Amortizim i shtesës		4,167,371
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		45,356,334
	5	Amortizim i akumuluar		31,502,854
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		13,853,480

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 77,350,197 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 77,350,197 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 2.*) në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		77,350,197
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		77,350,197
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		77,350,197
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		77,350,197

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 83,323,719 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 83,323,719 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 3.*) në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		83,323,719
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		83,323,719
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		83,323,719
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		83,323,719

- Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” u konstatua se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie por janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha

pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 947,377,449 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 41,761,849 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 326,101,933 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 928,402,185 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 4.) në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,214,742,269
	2	Amortizim i akumuluar	257,364,820
	3	Gjendja në 01.01.2024	947,377,449
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	41,761,849
	5	Amortizim i shtesës	60,737,113
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,256,504,118
	5	Amortizim i akumuluar	326,101,933
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	928,402,185

- Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” u konstatua se, vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30 dhe pika 75.

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,075,565,133 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka shtesa në vlerën 163,420,517 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 952,643,451 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,047,166,194 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,836,389,128
	2	Amortizim i akumuluar	760,823,995
	3	Gjendja në 01.01.2024	3,075,565,133
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	163,420,517
	5	Amortizim i shtesës	191,819,456
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,999,809,645
	5	Amortizim i akumuluar	952,643,451
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	3,047,166,194

- Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” u konstatua se, vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, pika 5

dhe *Kreu III pika 30, Aneksi 1 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, *pikat 26, 28, 30 dhe pika 75.*

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 40,230,912 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,525,197 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 37,987,854 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 44,031,406 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 5.*) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	74,494,063
	2	Amortizim i akumuluar	34,263,151
	3	Gjendja në 01.01.2024	40,230,912
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	7,525,197
	5	Amortizim i shtesës	3,724,703
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	82,019,260
	5	Amortizim i akumuluar	37,987,854
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	44,031,406

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 21,566,866 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 40,097,805 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,089,155 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 6.*) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	55,186,960
	2	Amortizim i akumuluar	33,620,094
	3	Gjendja në 01.01.2024	21,566,866
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	6,477,711
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	55,186,960
	5	Amortizim i akumuluar	40,097,805
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	15,089,155

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 5,810,110 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 16,610,460 lekë, pakësime në vlerën 16,562,640 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 40,754,744 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 820,144 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	41,527,068
	2	Amortizim i akumuluar	35,716,958
	3	Gjendja në 01.01.2024	5,810,110
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	16,610,460
	5	Amortizim i shtesës	5,037,786
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	16,562,640
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	41,574,888
	5	Amortizim i akumuluar	40,754,744
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	820,144

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 5,037,786 lekë (*kosto historike*) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një

ndarje të llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 3,462,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Sarandë me Nipt J64228814D është 584,304,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë me Nipt M24828802U. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Sarandë është 3,462,000 ose 4.57% ($34.62 \cdot 10,000,000 / 100 = 3,462,000$ lekë) nga ShRUKS. Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 31.

4. Invenstimet

- **Gjendja e llogarisë 231** “Investime për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2024 paraqitet në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2024 në këtë llogari janë regjistruar shtesa në vlerën 40,450,192 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e saj paraqitet në të njëjtën vlerë.

Analiza e detajuar e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Përshkrimi	Vlera (lekë)
Gjendje më 01.01.2024	0
Shtesa gjatë vitit	40,450,192
Pakësime	0
Gjendja më 31.12.2024	40,450,192

Sipas objekteve të investimit

Për aktive afatgjata materiale	Gjendja 01.01.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2024
Shkolla 9-vjeçare “5 Dëshmorët” Ksamil	0	35,091,592	0	35,091,592
Qendra e Rinisë Sarandë	0	5,358,600	0	5,358,600
Totali	0	40,450,192	0	40,450,192

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërsa llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 40,450,192 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se këto investime janë regjistruar gjatë vitit ushtrimor në llogarinë 231, në funksion të evidentimit të investimeve në proces. Pagesat e realizuara për këto investime janë likuiduar përmes sistemit të Thesarit dhe janë reflektuar në llogaritë përkatëse të mjeteve monetare dhe të shpenzimeve kapitale, ndërsa kapitalizimi I investimeve dhe reflektimi I tyre në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata realizohet në momentin e përfundimit dhe marrjes në dorëzim të investimit.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune*”, nuk ka një regjistër kontabël analitik të këtyre zërave ku ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, por nuk ka datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Gjithashtu për këto objekte nuk është kryer inventar dhe verifikim fizik mbi bazën e pronësisë pasi nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (*certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor*), pasi dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. **Këto veprime janë në kundërshtim me:** Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 6; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26-30, Kapitulli III, pika 35, pika 74; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Sarandë më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,682,077	1,132,200	3,549,877
42	Detyrime ndaj personelit	13,661,605	8,901,280	4,760,325
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,554,528	777,471	777,057
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0

435	Sigurime shoqërore	4,160,451	2,674,085	1,486,366
436	Sigurime shëndetësore	584,817	371,111	213,706
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	80,820	62,160	18,660
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	56,960,589	51,740,993	5,219,596
467	Kreditorë të ndryshëm	787,700	6,701,510	(5,913,810)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	794,848,106	672,416,005	122,432,101
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		877,320,693	744,776,815	132,543,878

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 1,132,200 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Sarandë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 3,549,877 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,682,077 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2024	1,132,200
Shtesa (K)	3,549,877
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2024	4,682,077

Lekë				
Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Datë	Vlera
1	OSHE	Energji	31.12.2024	3,733,737
2	ONE	Telefona	31.12.2024	24,648
3	Posta shqiptare	Shërbime postare	31.12.2024	271,537
4	Ujësjetllës kanalizime	Uji	31.12.2024	30,192
5	A & T	Karburant	31.12.2024	610,050
6	Dega e tatimeve	Tapi	31.12.2024	147
7	ASHK	Shpenzime kadrtrale	31.12.2024	8,500
8	DRTSH	Taksa automjeti	31.12.2024	3200
Totali				4,682,077

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 13,661,605 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë	
Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2024	8,901,280
Shtesa (K)	4,760,325
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2024	13,661,605

Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Lekë		
Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	06.01.2025	165,343
2	06.01.2025	1,328,699
3	06.01.2025	137,106
4	06.01.2025	272,255
5	06.01.2025	11,758,202
Totali		13,661,605

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 1,554,528 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë	
Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2024	777,471
Shtesa (K)	777,057
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2024	1,554,528

Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
6	06.01.2025	1,554,528
Totali		1,554,528

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 4,160,451 lekë.

Lekë

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2024	2,674,085
Shtesa (K)	1,486,366
Pakësime (D)	
Gjendja debitore në 31.12.2024	4,160,451

Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
8	06.01.2025	4,160,451
Totali		4,160,451

- **Llogaria 436 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 584,817 lekë.

Lekë

Llogaria 436 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2024	371,111
Shtesa (K)	213,706
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2024	584,817

Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
9	06.01.2025	584,817
Totali		584,817

- **Llogaritë, 437; 438 “Organizma të tjerë shtetërore”** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 80,820 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 437,438 “Organizma të tjerë shtetërore”	
Çelje e vitit 2024	62,160
Shtesa (K)	18,660
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2024	80,820

Lekë

Organizma të tjerë shtetërore	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Sigurim Suplementar Aparati	62,160	18,660	0	80,820
Totali	62,160	18,660	0	80,820

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë në mbyllje të vitit 2024, paraqitet në vlerën **56,960,589 lekë** dhe përfaqëson vlerën e garancive kontraktuale të mbajtura në Thesar, të cilat sipas kushteve kontraktuale mbahen në masën 5% të vlerës së kontratave të punimeve.

Analiza e lëvizjeve të kësaj llogarie gjatë vitit ushtrimor paraqitet si më poshtë:

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2024	51,740,993
Shtesa (K)	13,780,379
Pakësime (D)	8,560,783
Gjendja debitore në 31.12.2024	56,960,589

Nga analiza e detajuar e kësaj llogarie rezulton se nga totali i mjeteve në ruajtje një vlerë prej 43,609,960 lekë lidhet me 78 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Sarandë, për të cilat fondet përkatëse vijnë të jenë të ngurtësuara në Degën e Thesarit Sarandë.

Këto fonde përfaqësojnë garanci kontraktuale të mbajtura sipas kushteve të kontratave të punimeve dhe evidentohen në llogarinë 466 deri në momentin e përfundimit të periudhës së garancisë dhe kryerjes së procedurave përkatëse për zhbllokimin dhe likuidimin e tyre.

Në këtë kontekst, analiza e kësaj llogarie është paraqitur në funksion të interpretimit të strukturës së mjeteve në ruajtje dhe pasqyrimin të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, duke qenë se këto mjete përfaqësojnë fonde të mbajtura përkohësisht në Thesar në lidhje me kontratat e punimeve.

Në aspektin e pasqyrimin financiar, këto vlera ndikojnë në paraqitjen e detyrimeve të përkohshme në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, pasi evidentohen si mjete në ruajtje deri në përfundimin e procedurave përkatëse të zhbllokimit të tyre, ndërsa nuk ndikojnë në rezultatin e veprimtarisë ushtrimore, pasi nuk përfaqësojnë të ardhura apo shpenzime të ushtrimit.

Analiza e mësipërme është paraqitur në funksion të interpretimit të treguesve të pasqyrave financiare dhe pasqyrimin të mjeteve në ruajtje në fund të vitit ushtrimor.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 6,701,510 lekë. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 744,000 lekë dhe pakësime në vlerën 6,657,810 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 787,700 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		6,701,510
Shtesa (K)		744,000
Pakësime (D)		6,657,810
Gjendja kreditore në 31.12.2024		787,700

Lekë					
Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Numri i faturës	Datë	Vlera
1	Ylli Haska	Mallra	9466	07.05.2020	26,500
2	Shelege Veliaj	Shërbime	1	10.05.2018	17,200
3	Oltjan Hastoci	Materiale për zjarrfikësen	60	16.09.2024	744,000
Totali					787,700

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 672,416,005 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 122,387,228 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 794,848,106 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”		Lekë
Çelje e vitit 2023		672,416,005
Shtesa (K)		122,387,228
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2023		794,848,106

- Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Por si kundërparti në bilanc pasqyrohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. **Këto veprime janë në**

kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7.

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë, komponentët e **Aktiveve Neto/Fondeve** paraqiten si më poshtë

		Lekë	
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	5,054,776,084	4,870,150,831
D	FONDI I KONSOLIDUAR	5,054,776,084	4,870,150,831
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	4,261,721,711	4,270,186,464
12	Rezultatet e mbartura	117,277,379	177,029,513
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	675,776,994	422,934,854
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	5,932,096,777	5,614,927,646

Nga auditimi i lëvizjeve të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”, rezulton se kjo llogari në 01.01.2024 paraqitet në vlerën 4,270,186,464 lekë, e cila përfaqëson gjendjen e fondit të akumuluar të institucionit në fund të vitit ushtrimor 2023.

Gjatë vitit ushtrimor 2024 lëvizjet e kësaj llogarie lidhen kryesisht me ndryshimet e evidentuara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, si dhe me ndryshimin e gjendjes së inventarit.

		Lekë	
Fondi i konsoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”		
5,054,776,084	Mbyllje më datë 31.12.2024		Çelje më datë 01.01.2024
	Debi		Kredi
			Çelja gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” i datës 31.12.2023
		4,270,186,464	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	16,562,640	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	239,231,883
	271,964,140	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	379,952
Totali	288,526,705		4,509,798,299
		4,509,798,299 – 288,526,705 = 4,221,271,594	
		4,261,721,711 - 4,221,271,594 = 40,450,117	

Pra llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë, në datën 01.01.2024 paraqitet në vlerën 4,270,186,464 lekë.

Gjatë vitit ushtrimor 2024, lëvizjet e kësaj llogarie lidhen me ndryshimet e aktiveve afatgjata dhe elementët të tjerë kontabël që reflektohen në fondin e konsoliduar të institucionit. Konkretisht, gjatë vitit ushtrimor llogaria 101 është kredituar për shtesat e evidentuara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 239,231,883 lekë, si dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën 379,952 lekë.

Nga ana tjetër, gjatë të njëjtit vit ushtrimor kjo llogari është debituar për pakësimet e aktiveve në vlerën 16,562,640 lekë, si dhe për amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 271,964,140 lekë, sipas të dhënave të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet"**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 557,95,625 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 508,476,040 lekë ose me një pakësim në vlerën 49,483,585 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	508,476,040	557,959,625
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	1,068,566	763,227
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	1,068,566	763,227
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	126,937,692	126,967,766
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	120,018,278	111,556,809
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	6,919,414	15,410,957
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	380,469,782	430,228,632
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	380,469,782	430,228,632
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksë kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore"**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 169,193,042 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 218,734,965 lekë ose me një rritje në vlerën 49,541,923 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	218,734,965	169,193,042
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	24,825,460	9,347,034
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	24,825,460	9,347,034
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	193,411,649	158,559,700
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	169,946,772	150,339,600
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	16,880,700	6,301,500
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	287,250	425,500
7114	Të ardhura nga biletat	220,000	153,100
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	6,076,927	1,280,000
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	497,856	1,286,308

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 "Grante korente"**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 660,011,312 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 720,612,915 lekë ose me një rritje në vlerën 60,601,603 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	V. GRANTE KORENTE	720,612,915	660,011,312
720	1. Grant korent i brendshëm	720,612,915	660,011,312

7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	17,971,315	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	626,155,442	601,554,848
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	43,276,760	36,672,325
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	25,511,998	20,619,817
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	7,697,400	1,164,322
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 127,217,485 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 163,299,229 lekë ose me një rritje në vlerën 36,081,744 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 21,076,685 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 27,020,621 lekë ose me një rritje në vlerën 5,943,936 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Sarandë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	163,299,229	127,217,485
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	24,868,386	18,924,450
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	2,152,235	2,152,235
	Totali	190,319,850	148,294,170

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 286,877,072 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 309,307,530 lekë ose me një rritje në vlerën 22,430,458 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Sarandë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	309,307,530	286,877,072
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,564,352	1,636,500
6021	Materiale dhe shërbime speciale	5,507,340	7,330,006
6022	Shërbime nga të tretët	236,600,345	233,225,582
6023	Shpenzime transporti	12,752,561	5,617,488
6024	Shpenzime udhëtimi	1,923,638	1,902,347
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	15,832,697	10,726,223
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,556,450	1,408,450
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,180,000	675,187
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	31,390,147	24,355,289

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Sarandë nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 30,245,888 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 224,582,295 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

		Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE	254,828,183	517,595,738
604	1. Transferime korente të brendshme	30,245,888	301,323,176
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	3,995,888	300,323,176
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	6,000,000	1,000,000
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	20,250,000	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	224,582,295	216,272,562
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	224,582,295	216,272,562

Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin ushtrimor 2024 rezulton se totali i të ardhurave paraqitet në vlerën 1,447,823,920 lekë, ndërsa totali i shpenzimeve në vlerën 754,075,611 lekë, nga ku rezulton një diferencë prej 693,748,309 lekësh. Ndërkohë, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe Pasqyrës së Performancës Financiare, llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” paraqitet në vlerën 675,776,994 lekë, duke rezultuar një diferencë prej 17,971,315 lekë.

Nga analiza e elementëve të të ardhurave rezulton se në llogarinë 7200 “Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)” është evidentuar një vlerë prej 17,971,315 lekë, e cila lidhet me transfertat e realizuara në sistemin e Thesarit dhe reflektohet në Pasqyrën e Flukseve Monetare (Cash Flow). Në këtë kuadër, kjo vlerë nuk paraqitet si element i Pasqyrës së Performancës Financiare, por reflektohet në flukset monetare të institucionit.

Analiza e mësipërme paraqitet në funksion të interpretimit të treguesve financiarë dhe lidhjes ndërmjet Pasqyrës së Performancës Financiare dhe Pasqyrës së Flukseve Monetare, në lidhje me mënyrën e pasqyrimit të transfertave buxhetore në pasqyrat financiare.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1099/1 prot., datë 19.11.2025, “Mbi auditimin financiar”, të ushtruar në Bashkinë Sarandë, sipas programit të auditimit nr. 1099/1 prot., datë 19.11.2025, për veprimtarinë nga data 01.01.2024, deri në datën 31.12.2024, u kërkua informacion në lidhje me evidentimin e të dhënave mbi pronat që Bashkisë Sarandë të cilat i janë transferuar me VKM në periudha të ndryshme ushtrimore nga ku konstatohet se:

- Numri i pronave të transferuara me VKM sipas listës përfundimtare të inventarit dhe se sa prej tyre janë regjistruar ne ASHK, pasqyrohen në tabelën si më poshtë vijon.

Nr.		VKM		Në përdorim Në numër	Në pronësi Në numër	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë			
1	Bashkia Sarandë	Nr. 20	09.10.2008	336	4	4
		Nr. 336	31.05.2006			
		Nr. 46	16.01.2008			
		Nr. 1108	30.12.2015			
		Nr. 235	23.03.2011			
		Nr. 297	20.04.2016			
		Nr. 458	26.07.2018			
2	Ish Komuna Ksamil	Nr. 476	29.06.2011	2	40 (objekte dhe truall)	1

Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë.

Pronat e regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës se pronësisë evidentohe në tabelën sa me poshtë:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m ²	Sip nd. m ²	Pasqyruar ose Jo ne bilancin e Bashkisë.
1	Truall	15/452	1313032	26.05.2016	8642	Rr. Bilal Golemi	10800	313	jo
2	Shesh	7/384	1294671	20.01.2014	2297	Ksamil	2942		jo
3	Truall	8/249	1764708	29.01.2014	8642	Rr. Janaq Kumi	360000	84,000	jo
4	Truall	278	1135165	15.12.2014	3330	Shelegar	58	58	jo
5	Truall	15/421	1294365	14.01.2016	8642	Rr. Bilal Golemi	781		jo
6	Pyll	9	Elektronike	10.10.2023	2806	Sarandë	297875		jo
7	Kullotë	8	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	3920200		jo
8	Pyll	7	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	210900		jo
9	Kullotë	6	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	298876		jo
10	Kullotë	15	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	341230		jo
11	Kullotë	12	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	2564119		jo
12	Pyll	11	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	458570		jo
13	Pyll	10	Printuar elektronikisht	10.10.2023	2806	Sarandë	524661		jo

Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë.

Kërkesë sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, VKM-në nr. 684 datë 02.09.2020 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 433 datë 08.06.2016’ i janë kaluar në pronësi sipërfaqe pyje, kullota, toka inproduktive, shkëmbore e ujore sipërfaqja Gjithsej 5,133,81. ha, nga të cilat:

- Pyje 230.27 ha,
- Kullotë 1233.21 ha
- Toka joproductive 169 ha
- Shkëmbore dhe ujore 1,335.33 Ha, konkretisht sipas tabelës më poshtë:

Lloji	Ha
Pyje	230.27
Kullota, livadhe	1,233.21
Tokë bujqësore	2166
Urbane	1,165.30
Djerr (eroduar)	169
Shtrat lumi	15.5
Ujore	154.53
Totali	5,133.81

Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë.

Në total, Bashkisë Sarandë i janë transferuar 5,133.81 ha sipërfaqe sipas VKM-ve përkatëse, nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie 712.4 ha sipërfaqe pyjore dhe 149.2 ha sipërfaqe kullotë, gjithsej 861.6 ha të regjistruara. Bashkia Sarandë nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar këto sipërfaqe në pasqyrat financiare, në llogarinë përkatëse, duke mos pasqyruar në total 5,133.81 ha të transferuara në favor të saj, nga të cilat 430.9 ha sipërfaqe pyjore dhe 783.3 ha sipërfaqe kullotë, sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 59, shtojca nr. 57, e ndryshuar, si dhe VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 433” datë 08.06.2016. Kjo situatë sjell mospasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024, **në kundërshtim me:** Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 2.1.

Gjithashtu, nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, e cila paraqitet në pasqyrat financiare në vlerën 83,323,719 lekë, si

dhe nuk është hartuar raport mbi inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak të cilësisë dhe kushteve të ruajtjes, gjendjen fizike të tyre dhe evidentimin e mundshëm të diferencave. Po ashtu, gjatë vitit 2024 janë marrë 13 certifikata pronësie për pasuri të llojit kullotë dhe pyll, të cilat nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2024 në llogarinë 211 të Bashkisë Sarandë. **Këto veprime nuk janë në përputhje me:** ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenet 11 dhe 15, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenet 9 dhe 12, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës përgjithësisht është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve:

Nga Bashkia Sarandë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave, të cilat janë hartuar në përputhje me standardet e kontabilitetit. Në to janë pasqyruar pagat me të gjithë elementët përbërës dhe shtesat përkatëse deri në shumën bruto, si dhe janë evidentuar llojet e ndalesave deri në përcaktimin e pagës neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë-pagesat dhe urdhër-pagesat përkatëse, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar rregullisht detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Gjithashtu, janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve, si dhe dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8 paraqet informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit ushtrimor të mbyllur, si dhe gjendjen në fund të periudhës. Gjithashtu, pasqyra përfshin të dhëna mbi fondin e pagave gjithsej, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur paraqiten edhe llogaritë debitore dhe kreditore në mënyrë analitike, si dhe evidenca përmbledhëse e përdorimit të fondeve.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. O. Ç. Kryetar i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe **znj. T. S.** Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në datën 01.01.2024 paraqitej në vlerën 947,377,449 lekë. Gjatë vitit 2024, për këtë llogari janë evidentuar shtesa në vlerën 41,761,849 lekë, si dhe amortizim i akumuluar në vlerën 326,101,933 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e llogarisë paraqitet në vlerën 928,402,185 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie, u konstatua se vlera 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, *Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1*; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar *pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkia Sarandë të marrë masa për analizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” për vlerën 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në datën 01.01.2024 paraqitej në vlerën 3,075,565,133 lekë. Gjatë vitit 2024, për këtë llogari janë evidentuar shtesa në vlerën 163,420,517 lekë, si dhe amortizim i akumuluar në vlerën 952,643,451 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e llogarisë paraqitet në vlerën 3,047,166,194 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie, u konstatua se vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, *Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1*; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar *pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të marrë masat për analizimin e vlerës 29,568,137 lekë, e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, për llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, është përlllogaritur amortizimi i akumuluar deri në datën 31.12.2024 në vlerën 25,787,766 lekë, mbi koston historike, duke aplikuar normën e amortizimit në masën 20%. Ndërkohë, nuk është kryer ndarja e llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik”, për të cilat

norma e amortizimit e aplikueshme është në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masat për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 “Pajisjet kompjuterike” brenda llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në regjistrin e asetëve të njësisve dhe në pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” u konstatua se kjo llogari paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 3,462,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqëria Aksionare Ujësjetellës Kanalizime Sarandë është 584,304,000 lekë, e cila është bërë pjesë e Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Sarandë. Pjesëmarrja e Bashkisë Sarandë në kapitalin e kësaj shoqërie është në vlerën 3,462,000 lekë, ose 4.57%. Ndërkohë, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune” u konstatua se nuk ekziston një regjistër kontabël analitik për këto aktive, i cili të përmbajë informacion të plotë për secilin aktiv, si data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, personi përgjegjës, periudha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe data e daljes nga pronësia. Në këto kushte, nuk sigurohet informacion i saktë mbi gjendjen kontabël të aktiveve, e cila duhet të krahasohet me gjendjen faktike gjatë inventarizimit fizik vjetor, për verifikimin dhe sistemimin e vlerave të tyre në kontabilitet. Për rrjedhojë, nuk mund të krijohet siguri e arsyeshme mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e vlerave të pasqyruara në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për këto llogari, duke pamundësuar dhënien e një opinioni të plotë mbi to.

Gjithashtu, për këto objekte nuk është kryer inventarizim dhe verifikim fizik mbi bazën e pronësisë, pasi ato nuk janë pajisur me certifikata pronësie. Si pasojë, kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale që përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor), ndërkohë që dokumenti që vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Po ashtu, Bashkia Sarandë nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare, në llogarinë përkatëse, sipërfaqen totale prej 5,133.81 ha të transferuara në favor të saj, nga të cilat

430.9 ha sipërfaqe pyjore dhe 783.3 ha sipërfaqe kullotë, sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike...”, pika 59, shtojca nr. 57, e ndryshuar, dhe VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 433” datë 08.06.2016. Kjo situatë sjell pasqyrim të pasaktë dhe të drejtë të llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024. Gjithashtu, nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për këtë llogari, e cila paraqitet në pasqyrat financiare në vlerën 83,323,719 lekë.

Në vijim, nuk është hartuar raport mbi inventarizimin fizik të aktiveve, përfshirë vlerësimin paraprak të cilësisë dhe kushteve të ruajtjes, gjendjen fizike të tyre, si dhe evidentimin e mundshëm të diferencave. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë marrë 13 certifikata pronësie për pasuri të llojit kullotë dhe pyll, të cilat nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2024, në llogarinë 211 të Bashkisë Sarandë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 6; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26–30, Kreu III pika 35 dhe pika 74; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 2.1. Kreu II pikat 5 dhe 36, si dhe Kreu III pika 30; si dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për menaxhimin e aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Ekspertë vlerësues të licencuar të aseteve, të bëhet vlerësimi i pronave të regjistruara por pa vlerë, si dhe të vijohet me regjistrimin në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT